

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT përmes trupit gjykues përbërë nga Gjyqtarja e lëndëve civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA si kryetare e trupit gjykues, Gjyqtarit vendor MUHAMET REXHIA dhe Gjyqtarit vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtar të trupit gjykues,

*Në lëndën civile të paditësit Ndërmarrja Shoqërore "FABRIKA E BATERIVE" - GJILAN, gjatë procedurës të riemëruar në- N.Sh. "FABRIKA E BATERIVE"- GJILAN, me Agjencinë Kosovare të Privatizimit si përfaqësues i saj ligjor, sipas Nenit 29, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.19/2011), kundër të paditurit të mëhershëm ISA KRASNIQI nga GJILANI, pas vdekjes së tij me 3 gusht 2010 të zëvendësuar me trashëgimtarët e tij BELGIZARE KRASNIQI - bashkëshortja, GENC KRASNIQI dhe MILOT KRASNIQI djemtë, të gjithë nga GJILANI me përfaqësuesin e tyre ligjor Avokatin NASUF NASUFI nga GJILANI, pas padisë për anulimin e kontratës mbi bartjen e pronës së paluajtshme me baze ligjore nga Neni 109 *in fine* dhe Neni 110 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD) (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 29/1978, me amendamentet në Nr. 39/1985, 45/1989, 57/1989 dhe Gazeta Zyrtare e RFJ Nr. 31/1993),*

Duke vendosur mbi ankesën e ushtruar kundër Aktgjykimit C.nr.127/2005 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 4 dhjetor 2009 për aprovimin e kërkesëpadisë të lartpërmendur, në seancën e trupit gjykues, bazuar në Nenin 190, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurë Kontestimore (LPK) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008), të mbajtur me 23 dhjetor 2011,

Përmes kësaj, sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika d) në lidhje me Nenin 200 LPK merr këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga BEKGIZARE KRASNIQI, GENC KRASNIQI dhe MILOT KRASNIQI si trashëgimtarët ligjor të ISA KRASNIQI, të gjithë nga GJILANI, dhe **VËRTETOHET** Aktgjykimi C.nr.127/2005 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, i datës 4 dhjetor 2009.

ARSYETIMI

I. Historiati procedural

1. Me Aktgjykimin C.nr.127/2005 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 4 dhjetor 2009 është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e N.Sh. "FABRIKA E BATERIVE"-GJILAN dhe është anuluar kontrata mbi bartjen e pronës së paluajtshme e lidhur ndërmjet fabrikës së njëjtë dhe ISA KRASNIQI nga GJILANI, e vërtetuar në Gjykatën Komunale të GJILANIT me shenjën Vr.nr.2051/2002 me 6

shtator 2002. Gjithashtu është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës gjyqësore.

2. Me 17 dhjetor 2010, është paraqitur ankesa në emër të ISA KRASNIQI kundër Aktgjykimit duke e kundërshtuar atë në tërësi mbi bazat e *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas Nenit 182 LPK, *vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike* sipas Nenit 183 LPK, sikurse edhe *për aplikimin e gabuar të drejtës materiale* sipas Nenit 184 LPK. Është kërkuar që të anulohet Aktgjykimi dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë.

3. Sipas Nenit 187, paragrafi 1 LPK me 20 janar 2011 kopjet e ankesës iu janë dorëzuar REXHIB SYLEJMANIT, Drejtor i N.Sh. "FABRIKA E BATERIVE" – GJILAN dhe XIHELAL SALIHU, Zyrtar ligjor i AKP-së – Zyra Regjionale – GJILAN për të dhënë përgjigje brenda 7 ditëve. Kjo e fundit është ushtruar me 26 janar 2011 – përfaqësuesi ligjor i ankuesit kërkoj që të refuzohet ankesa dhe të vërtetohet Aktgjykimi C.nr.127/2005 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, i datës 4 dhjetor 2009.

4. Me 26 janar 2011, Gjykata Komunale e GJILANIT iu dërgoi ankesën, përgjigjën në ankesë dhe shkresat e lëndës Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, sipas Nenit 188, paragrafi 1 LPK, ku janë regjistruar nën shenjën AC.nr.49/11.

5. Në procedurë të shkallës së dytë, përmes Certifikatës së Vdekjes N.Sr.V00063296, me numër rendor nr.25, numër referues nr.76060, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil – GJILAN, është vërtetuar se ISA KRASNIQI vdiq me 3 gusht 2010. Në mënyrë që të rregullohet trashëgiminë procedurale ligjore të ndërgjyqësit të vdekur, procedura ankimore është pezulluar sipas Nenit 277, pika a) LPK me Aktvendimin AC.nr.49/11 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 4 nëntor 2011. Procedura ka rifilluar me 9 nëntor 2011 kur BEKGIZARE KRASNIQI, GENC KRASNIQI dhe MILOT KRASNIQI, të gjithë nga GJILANI si trashëgimtarë të ISA KRASNIQIT, të evidentuar me Aktvdekjen Nr.1716, të lëshuar nga Departamenti i Administratës së Përgjithshme – GJILAN me 11 gusht 2011, kanë paraqitur parashtresë me shkrim për marrjen e procedurës sipas Nenit 280, paragrafi 1 LPK.

II. Kompetencat e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT

6. Kjo lëndë civile e shkallës së dytë AC.nr.49/11 të GjQ të GJILANIT është përzgjedhur bazuar në Nenin 5, paragrafi 1, pika c) të Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat") (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/08) në bazë të Aktvendimit të lëshuar me 18 korrik 2011 nga Gjyqtari të EULEX-it duke vepruar si i deleguari i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Vendimit me nr. ref. JC/EJU/OPEJ/2496/ff/11, të datës 5 korrik 2011. Ky i fundit, pas zhvillimit të procedurës për marrjen përsipër të lëndës si është paraparë me Nenin 5, paragrafi 7, fjalia e parë të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat dhe Nenin 3, paragrafi 7 të Udhëzimeve për përzgjedhjen e lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët civile, të miratuara nga Asambleja e

Gjyqtarëve të EULEX-it me 27 janar 2011, lëshoi me 22 gusht 2011 një Aktvendim sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e dytë të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat për ta caktuar këtë lëndë trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, bazuar në Nenin 5, paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, të përbërë nga Gjyqtari i EULEX si Kryetar të trupit gjykues dhe dy Gjyqtarëve vendor si anëtarë të trupit gjykues. Këta të fundit, pas Vendimit mbi përjashtim me nr.ref. JC/EJU/OPEJ/2496/II/11 të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 5 korrik 2011 sipas Nenit 5, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat janë caktuar sipas vendimit Agj.nr.172/11 të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 25 gusht 2011.

7. Duke qenë i përbërë ligjërisht në pajtim me kriteret specifike të Nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, ky trup gjykues i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT është i autorizuar të gjykoj lëndën AC.nr.49/2011 bazuar në kompetencat funksionale të Gjykatës së shkallës së dytë siç është paraparë sipas dispozitave të përgjithshme të Nenit 15, paragrafi 2 dhe Nenit 176, paragrafi 3 LPK.

III. Lejueshmëria e ankesës dhe procedura e shkallës së dytë

8. Nuk ekzistojnë pengesat procedurale për të vendosur sipas ankesës. *Së pari*, nuk ndalohet parashtrimi i saj por është i paraparë në mënyrë eksplicite sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK me që vendimi i atakuar gjyqësor është Aktgjykim i shkallës së parë me vendim meritor sipas padisë. *Së dyti*, ankesa nuk është e paafatshme sipas kushteve të Nenit 186, paragrafi 2 LPK. Aktgjykimi C.nr.127/2005 të Gjykatës Komonale të GJILANIT, i datës 4 dhjetor 2009 iu është dorëzuar Avokatit VLASTIMIR PETROVIC, përfaqësues i autorizuar i të paditurit në lëndën e shkallës së parë, me 14 dhjetor 2010. Ankesa është ushtruar me 17 dhjetor 2010 para skadimit të afatit 15-ditësh, siç parashihet me Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë LPK, që ishte me 19 dhjetor 2010. *Së treti*, ankesa nuk është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3 LPK. Ajo është parashtruar nga ana e trashëgimtarëve ligjor i të paditurit në procedurë të shkallës së parë, dhe çdonjëri prej tyre kanë pasur individualisht të drejtën procedurale dhe interesin ligjor për ta parashtruar atë. Nuk ka pasur deklarime për refuzim apo tërheqje të ankesës nga asnjëra anë. *Së katërti*, ajo ka përmbajtje siç kërkohet me Nenin 178, pikat a) – d) LPK dhe nuk është jo e plotë sipas Nenit 179, paragrafi 1 LPK. Shkurtimisht, nuk ekzistojnë bazat ligjore që përjashtojnë lejueshmërinë e ankesës dhe të procedurës së shkallës së dytë sipas Nenit 176 – 205 LPK të iniciuar nga ajo.

IV. Përmbledhje e procedurave të shkallës së parë

9. Me 23 shkurt 2005, N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE - IBG” parashtroi padi kundër ISA KRASNIQI për anulimin e kontratës, të vërtetuar nga Gjykata Komonale e GJILANIT sipas shenjës Vr.nr.2051/02 me 6 shtator 2002, përmes së cilës paditësi, në vend të pagesës së kompensimit për të ardhura personale që i kishte borxh të paditurit në shumë prej 14790 Euro, ia bartë atij në pronësi të përhershme një shitore,

të vendosur në GJILAN, ndërtesa banesore dhe afariste P+6+PK, numri teknik i Projektit kryesor 494 – lokali afarist “D” P+6+PK, ish rruga “RADE POPOVIC”, tani rruga “BRIGADA e UÇK-së”, në sipërfaqe prej 38.65 m², të regjistruar në Fletën Poseduese nr.4650, Zona Kadastrale (ZK) GJILAN. Kontrata është atakuar si e lidhur në mënyrë të paligjshme pa baza ligjore për ta bartur pronën shoqërore të administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/12. Në emër të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG”, ajo është nënshkruar nga ATULLA QERIMI, në atë kohë Sekretar i ndërmarrjes, bazuar në Autorizimin nr.339/02, të datës 9 shtator 2002, të dhënë nga i padituri pa vendimin e Këshillit të Punëtorëve dhe me mungesë të ligjshmërisë për këtë autorizim, meqenëse ndërmarrja ishte nën administrim të AKM-së. Prandaj, kontrata kishte mangësi ligjore në lëndën dhe bazat e saj, ashtu që vërtetimi i saj ishte i palejueshëm. Kërkesëpadia ishte anuluar si nule dhe e pavlefshme.

10. Gjykimi në lëndën C.nr.127/2004 të Gjykatës Komunale të GJILANIT filloi me seancën përgatitore me 6 prill 2005, e cila është shtyrë për shkak të mos- dërgimit të thirrjes AKM-së si përfaqësuese ligjore të ndërmarrjes shoqërore- paditësit. Seanca është mbajtur me 5 maj 2005 – përfaqësuesi i paditësit e precizoi padinë, përfaqësuesi i të paditurit iu përgjigj asaj, dhe të dyja palët parashtruan propozimet veta për grumbullimin e dëshmimeve në procedurë të shkallës së parë.

11. Në seancën për shqyrtim kryesor të mbajtur me 7 qershor 2005 është dëgjuar i padituri ISA KRASNIQI, ndërsa dëshmitarët SAMI KRASNIQI dhe EROL IMAMI dhanë dëshmitë e tyre dhe është caktuar eksperti i grafologjisë për ta përcaktuar vërtetësinë e nënshkrimit të SAMI KRASNIQIT në cilësinë e ish- kryetarit të Këshillit të Punëtorëve të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE” IBG” lidhur me Autorizimin e sipërpërmendur nr.339/2002, të datës 9 shtator 2002. Seancat e mëpasshme të caktuara për shqyrtim kryesor me 9 nëntor, 22 nëntor dhe 12 dhjetor 2005 ishin shtyrë.

12. Me Urdhëresën C.nr.127/2005 të Gjykatës komunale të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2012 ekspertiza grafologjike iu është caktuar Shërbimit Policor të Kosovës– Njësia e Mjekësisë Ligjore në PRISTINË. Kjo e fundit, përmes letrës me numër ref. LF/KKP-05-54, të datës 14 dhjetor 2002 e ka refuzuar me që në atë kohë kjo Njësi punonte vetëm në rastet penale bazuar në Kapitullin XXII “Ekspertët” të Kodit të Përkohshëm për Procedurë Penale të Kosovës. Pas kësaj përgjigjeje, me 9 janar 2006 Gjykata Komunale e GJILANIT dërgoi kërkesë për ndihmë ndërkombëtare ligjore në Departamentin e Drejtësisë. Pas korrespondencës 2-vjeçare brenda institucioneve të ndryshme lidhur me këtë çështje, ekspertiza grafologjike ishte kryer nga ana e Qendrës për Mjekësi Ligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kroacisë – përmes Raportit mbi Ekzaminim nr.511-01-43/IV-1149/-7.I.J, i datës 26 mars 2008 për Nënshkrim dhe sipas Ekspertit të Dokumenteve Prof. IGOR JELOVAC nënshkrimi i SAMI KRASNIQIT në Autorizimin nr.339/2002, të datës 9 shtator 2002 është vërtetuar si autentik.

13. Seanca për shqyrtim kryesor vazhdoi me 17 qershor 2009 përfaqësuesit e palëve dhanë deklaratat dhe propozimet e tyre për marrje në pyetje në cilësi të dëshmitarëve- anëtarët e Komisionit për Çështje Pronësore të pronës së Paluajtshme të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE IBG” - ALAUDIN SERIFI i cili dëshmoi me 31 korrik 2009, ATULLA QERIMI me 5 tetor 2009 dhe FAZLI AHMETI me 4 dhjetor 2009. Në këtë seancë të fundit palët prezantuan fjalët e veta përfundimtare me arsyetimet e tyre mbi aspektet faktike dhe ligjore të kontestit dhe kështu seanca për shqyrtim kryesor u kompletua.

14. Me Aktgjykimin C.nr.127/2005 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 4 dhjetor 2009 kërkesëpadia u APROVUA në tërësi si e bazuar dhe kontrata mbi bartjen e pronës së paluajtshme e lidhur ndërmjet N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE IBG” - GJILAN dhe ISA KRASNIQI nga GJILANI, që ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale e GJILANIT me shenjën Vr.nr.2051/2002, e datës 6 shtator 2002, ishte ANULUAR. Gjithashtu është vërtetuar që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurës për shkak të mungesës së kërkesës nga paditësi për kompensim.

V. Ekzaminimi ankimor i Gjykatës së shkallës së dytë sipas Nenit 194 LPK

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore - Neni 182 LPK

15. Arsyeja e parë për atakimin e Aktgjykimit C.nr.127/05 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 4 dhjetor 2009 është sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK për *shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK*. Megjithatë, arsyet ligjore në të cilat thirren nuk janë të dëshmuara. *Së pari*, dispozitivi nuk është i paqartë ose jo i plotë. Në pajtim me Nenin 160, paragrafi 3 LPK diapozitivi përmban vendimin me të cilin të drejtat e paditësit lidhur me çështjen themelore iu janë dhënë si dhe vendimi mbi harxhimet e procedurës. Domethënë, kontrata e kontestuar, e anuluar me aprovim të plotë të kërkesëpadiës, është veçuar në dispozitiv nga palët, lloji (titulli), numri dhe data e vërtetimit në Gjyq. Pra është precizuar me karakteristikat e saja thelbësore deri në shkallë të mjaftueshme për identifikim të saj. Përshkrimi i lokalit afarist – lënda e kësaj kontrate, nën pikën 1 të kontratës, nuk është nevojë e detyrueshme e dispozitivit dhe për atë mos-përfshirja e saj nuk formon një mangësi formale dhe/ose procedurale. Të gjitha këto detaje nga përmbajtja e kontratës së kontestuar janë kopjuar në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar gjë që është vend korrekt e i rregullt sipas Nenit 160, paragrafi 4 LPK. Në fund, dispozitivi është i formuluar në përputhje të plotë me formulimin e kërkesëpadiës siç kërkohet me Nenin 2, paragrafi 1 LPK. Ajo nuk është as e pakuptueshme e as kontradiktore në vetvete, në të kundërtën prej thënieve të cekura në ankesë. *Së dyti*, kontratës së anuluar i referohet si të lidhur ndërmjet N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE IBG” – GJILAN dhe ISA KRASNIQI nga GJILANI dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale e GJILANIT me shenjën Vr.nr.2051/2002, të datës 6 shtator 2002” në dispozitiv të Aktgjykimit, ndërsa në *arsyetimin* veçmas nga kjo, më tej është veçuar si një për bartje të pronës së paluajtshme të vendosur në GJILAN, ndërtesa banesore dhe afariste P+6+PK, me numër teknik të Projektit kryesor 494 – lokal afarist “D” P+6+PK, ish rruga “RADE POPOVIC”, tani rruga

“BRIGADA e UÇK-së”, në sipërfaqe prej 38.65 m², e regjistruar në Listës Poseduese nr.4650, ZK GJILAN. Pra dispozitivi dhe arsyetimi i Aktgjykimit si pjesë përbërëse të tij e *plotësojnë njëra tjetrën pa kontradikta* brenda kufijve të Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK. *Së treti*, provat e mbledhura në procedurë të shkallës së parë nuk e themelojnë as veçmas e as në tërësi ligjshmërinë e kontratës së atakuar dhe/ose as që është e vlerësuar si e tillë në Aktgjykim. Pra, nuk ka mospërputhje sa i përket Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK ndërmjet *provave të administruara*, vlerësimit të tyre nga ana e Gjykata e shkallës së parë në *arsyetim* dhe anulimit i së njëjtës kontratë si nule dhe e pavlefshme në *dispozitiv*. *Së katërti*, nuk ka mospërputhje sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK ndërmjet asaj çka është reflektuar në arsyetim të Aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve dhe procesverbaleve të deklaratave dhënë gjatë procedurës së dhe përmbajtjes së tanishme të atyre dokumenteve dhe procesverbaleve. Në veçanti, dëshmitë e dëshmitarëve EROL IMAMI dhe ATULLA QERIMI janë përsëritura me saktësi në Aktgjykim sipas Nenit 160, paragrafi 4 LPK siç janë shënuar në procesverbalin e seancës së 7 qershor 2005 dhe respektivisht të asaj të 5 tetor 2009. Megjithatë, ato janë të *papranueshme* në atë pjesë ku këta dy dëshmitarë dëshmojnë për mungesë të ndonjë shkeljeje ligjore në këtë rast, domethënë për nevojën jo të domosdoshme të pëlqimit nga AKM-ja për ta lidhur kontratën e kontestuar dhe respektimin e kriterëve të procedurës për vërtetimin e së njëjtës kontratë. Këto janë *mendime ligjore* të këtyre personave fizik, të cilat nuk janë zyrtare dhe të detyruese për Gjykatën. Me që nuk janë *vërtetuar faktet* bazuar në këto deklarata siç kërkohet me Nenin 339, paragrafi 2 LPK, *ato nuk paraqesin dëshmi të dëshmitarëve dhe si të tilla nuk kanë vlerë provuese* bazuar në Nenin 319, paragrafi 2 LPK. Personat e thirrur në Gjyq si dëshmitarë sipas përkufizimeve eksplicite të Nenit 339, paragrafi 2 LPK mund të japin informata vetëm për *fakte* të cilat duhet të vërtetohen dhe *anasjelltas* ata nuk kanë të drejtë të japin kualifikime ligjore ose ndonjë koment tjetër ligjor për fakte të tilla. Për atë shkak, deklaratat e sipërpërmendura të EROL IMAMI dhe ATULLA QERIMI janë të papranueshme si dëshmi të dëshmitarëve dhe nuk kanë vlerë ligjore e as provuese në këtë padë. Si pasojë, vlerësimi i dëshmimeve të Gjykatës së shkallës së parë nuk mund konsiderohen si të pasakta për mospërfillje të këtyre deklaratave ose për mospërputhje me interpretimin e tyre në ankesë. Ky dallim nuk është një shkelje procedurale brenda kufijve të Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK. *Së pesti*, Aktgjykimi përmban arsye të qarta dhe objektive për sa i përket fakteve materiale, vendimtare për këtë kontest, të cilat nuk janë të dykuptimta ose kontradiktore dhe plotësisht e arsyetojnë marrjen e tij. Mungesa e arsyetimit për fakte *jorelevante* për anulimin e kontratës së kontestuar nuk është mangësi procedurale- sipas Nenit 319, paragrafi 2 LPK Gjykata duhet të bazoj vendimin e saj *vetëm mbi faktet që janë relevante* për marrjen e vendimit, duke mos i përfillur fakte tjera edhe nëse janë të paraqitura gjatë procedurës. Pas shqyrtimit, trupi gjykues konsideron se gabimet sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK të cekura në ankesë nuk ekzistojnë dhe nuk arsyetojnë aprovimin e saj.

16. Nuk janë vërtetuar shkeljet e procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) LPK të cilat Gjykata e shkallës së dytë është e obliguar t'i vërtetoj *sipas detyrës zyrtare* brenda këtij ekzaminimi ankimor sipas Nenit

194 LPK. Aktgjykimi është marr sipas padisë që bie brenda kompetencave ekskluzive territoriale të Gjykatës Komonale të GJILANIT sipas Nenit 41 LPK në rastet lidhur me kontestet pronësore (*Neni 182, paragrafi 2, pika b) LPK*). Nuk është bazuar në disponim të paligjshëm të palëve sipas Nenit 3, paragrafi 3 LPK (*Neni 182, paragrafi 2, pika g) LPK*). Asnjërit prej ndërgjyqësve nuk iu është mohuar e drejta për interpretim në gjuhën e saj/tij gjatë seancës për shqyrtim kryesor siç është paraparë me Nenin 96 LPK (*Neni 182, paragrafi 2, pika j) LPK*). Personat të cilët kanë marrë pjesë në këtë lëndë kishin të drejtë të veprojnë si palët me cilësinë e kërkuar procedurale dhe përfaqësim të duhur (*Neni 182, paragrafi 2, pika k) LPK*). Prezenca e publikut në seancën për shqyrtim kryesor e garantuar me Nenin 444, paragrafi 1 LPK nuk ishte përjashtuar në asnjërën prej seancave (*Neni 182, paragrafi 2, pika m) LPK*).

17. Brenda përkufizimeve të ekzaminimit ankimor në mënyrë të domosdoshme e definuar me Nenin 194 LCP, Gjykata e shkallës së dytë konstaton se shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK të cekura në ankesë dhe ato sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) LPK, të rregulluara sipas *detyrës zyrtare*, nuk ekzistojnë. Shkeljet tjera procedurale, pavarësisht nga realiteti, nuk mund të vërtetohen me që nuk janë të përfshira në kufijtë e lejuara të ekzaminimit ankimor, të përkufizuara me Nenin 194 LPK. Për atë Aktgjykimi i atakuar nuk mund të anulohet për arsye procedurale sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike - Neni 183 LPK

18. Arsyecja e *dytë* në ankesë është sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika b) LPK për *vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*. Megjithatë, ajo nuk është e pabazuar për sa i përket kriterit nga Neni 183, paragrafi 1 LPK – Gjykata e shkallës së parë nuk vërtetoi ndonjë provë të duhur në mënyrë të gabuar dhe nuk dështoi për ta vërtetuar atë.

19. Është një fakt publikisht i njohur e i pakontestuar, por në të kundërtën është i pranuar nga palët sipas Nenit 321, paragrafët 1 dhe 2 LPK se me 13 qershor 2002 (data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit), dhe me 6 shtator 2002 (data e vërtetimit të kontratës Vr.nr.2051/02 nga Gjykata Komonale e GJILANIT), N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” ishte një *ndërmarrje shoqërore* sipas Nenit 2, paragrafi 1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 77/1988 me amendamente në Gaz. Zyrtare Nr. 40/1989, Nr. 46/1990 and Nr.61/1990).

20. Bazuar në përjashtimin sipas Nenit 321, paragrafi 1 LPK nuk kishte nevojë për ta vërtetuar atë në lëndën C.nr.127/05 të Gjykatës Komonale të GJILANIT siç ishte vërtetuar në procedurat e mëparshme se me Aktgjykimin C.nr.236/1992 të Gjykatës Komonale të GJILANIT, të datës 11 qershor 1996 ishte aprovuar kërkesëpadia e ISA KRASNIQIT me anulimin e Vendimit nr.15/209, të datës 11 shkurt 1991 dhe Vendimit nr.284, të datës 25 shkurt 1991 të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kjo ndërmarrje si *punëdhënës* ishte e obliguar ta kthej atë në punë si *punëmarrës* në vendin e tij të mërishëm të punës si

“inxhinier”. Me Aktgjykimin AC.nr.334/96 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 23 dhjetor 1996 ankesa e N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” kundër këtij Aktgjykimi të shkallës së parë ishte refuzuar. Me Aktgjykimin Rev.nr.4769/2007 të Gjykatës Supreme të Serbisë, të datës 22 korrik 1998 edhe revizioni ishte refuzuar gjithashtu.

21. Ekzekutimi i iniciuar nga ISA KRASNIQI bazuar në Aktgjykimin C.nr.236/92 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 11 qershor 1996 pas plotfuqishmërisë me 23 dhjetor 1996 fillimisht ishte lejuar me Vendimin mbi ekzekutim E.nr.26/97 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 4 mars 1997. Më vonë ekzekutimi ishte shtyrë me Vendimin AC.nr.322/1997 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 22 qershor 1998, i cili Vendim e ndryshoj Vendimin E.nr.26/97 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 5 qershor 1997, derisa të finalizohet revizioni i sipërpërmendur sipas Nenit 63, paragrafi 1, nënparagraf 1 të Ligjit mbi Procedurë Ekzekutive (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 20/1978) (LPE 1978). Pas skadimit të afatit për të cilin afat edhe është shtyrë, ekzekutimi vazhdoi bazuar në Vendimin E.nr.51/2002, të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 1 shkurt 2002 sipas Nenit 67, paragrafi 1 LPE 1978. Brenda procedurës përmbartimore për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës në N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” sipas Nenit 231 LPE 1978, ISA KRASNIQI i propozoi Gjykatës, bazuar në këtë Vendim, ta obligoj punëdhënësin t’ia paguaj atij kompensimin për të ardhurat mujore të cilat do t’i kishte marrë po të kishte qenë në punë sipas Nenit 232, paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 LPE 1978. Lidhur me këtë, ekspertiza financiare e llogaritë këtë kompensim për periudhën prej 11 shkurt 1992 – 24 maj 2002 në shumë prej 14 287.58 Euro. Megjithatë, nuk ekziston vendim gjyqësor sipas Nenit 232, paragrafi 3 LPE 1978 me anë të cilit propozimi i ISA KRASNIQIT për kompensim ishte aprovuar për këtë ose ndonjë shumë tjetër duke e obliguar N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” ta paguaj atë.

22. Komisioni për Çështje Pronësore të Pronës së Paluajtshme të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” me 6 gusht 2002 morri një Vendim me numër të Protokollit nr.118/02 që ISA KRASNIQI, në vend të pagesës së kompensimit të dëmit në shumë prej 14 790 Euro – vlera e caktuar nga eksperti i Gjykatës – të pranoj në pronësi të përhershme shitoren në sipërfaqe prej 38.65 m² të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” në Ndërtesën Banësore dhe Afariste P+6+PK, ish rruga “RADE POPOVIC”, tani rruga “BRIGADA e UÇK-së”, numri teknik i Projektit kryesor 494, shitorja “D” P+6+PK, e regjistruar në Listës Poseduese nr.4650, ZK GJILAN. Ky Vendim ishte nënshkruar nga FAZLI AHMETI, ALAUDIN SHERIFI dhe ATULLA QERIMI si anëtarë të Komisionit. Ky i fundit, megjithatë, ishte caktuar në bazë të Vendimit me numër të Protokollit nr.132/02 të Këshillit të Punëtorëve, të datës 8 gusht 2002.

23. Përmes Autorizimit me shkrim nr.339/2002, të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Punëtorëve të N.Sh. “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” me 9 shtator 2002 ATULLA QERIMI nga GJILANI, jurist i punësuar si Sekretar i saj, ishte autorizuar ta përfaqësoj këtë ndërmarrje shoqërore në Gjykatën Komunale të GJILANIT dhe ta nënshkruaj në emrin e ndërmarrjes një kontratë mbi bartje të

paluajtshmërisë shitore, pronë e ndërmarrjes të ISA KRASNIQI si kompensim në kundërvlerë për atë dëmshpërblim.

24. Kontrata e kontestuar mbi bartje të pronës së paluajtshme ishte lidhë me shkrim ndërmjet N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" e përfaqësuar, bazuar në tekstin e kontratës, nga Sekretari i saj ATULLA QERIMI dhe ISA KRASNIQI dhe ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale e GJILANIT me shenjë Vr.nr.2051/2002 me 6 shtator 2002. Ishte dakorduar që N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG", në vend të pagesës së kompensimit të dëmit në shumë prej 14 790 €, ta bartë të ISA KRASNIQI shitoren e lartpërmendur dhe të ndërpriten të gjitha obligimet e papaguara ndaj tij. Kontrata nuk ishte regjistruar në N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" me numër të Protokollit dhe nuk ishte vulosur.

25. Në procedurë të shkallës së parë të gjitha provat e propozuara nga palët ishin grumbulluar rregullisht. Duke e marrë Aktgjykimin e saj Gjykata Komunale e GJILANIT ekzaminoj në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me kujdes çdonjërin pjesë të provave veç e veç dhe të gjitha së bashku - Neni 8, paragrafi 2 LPK. Bazuar në këtë ekzaminim, si dhe në gjendjen e përgjithshme të nxjerrë gjatë procedurës, Gjykata vendosi se cilat fakte të paraqitura nga palët ishin vërtetuar - Neni 8, paragrafi 1 LPK, dhe pastaj e zgjidhi padinë duke i përdorur ato që kishin lidhje me çështjen - Neni 319, paragrafi 2 LPK. Gjendja faktike në Aktgjykimin e ankimuar, prandaj nuk mund të cilësohet si *e gabuar* për shkak se është e pabazuar mbi provat e të paditurit në procedurë të shkallës së parë ose të ndryshme nga pretendimet e tij. Për më tepër, nuk mund të cilësohet si *jo e plotë* për shkak të mospërfilljes së fakteve që nuk janë në lidhje me këtë kontest. Ajo i referohet atyre të përmendura në ankesë – borxhi i N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" që i ka ISA KRASNIQIT sipas Vendimeve ekzekutuese E.nr.26/97, të datës 4 mars 1997 dhe E.nr.51/02, të datës 1 shkurt 2002, situatës financiare të kësaj ndërmarrjeje, motivet për ta rregulluar bartjen e pronës së paluajtshme të kontestuar dhe realizueshmërinë e kësaj marrëveshjeje. Asnjëra nga këto fakte nuk bien nën objekt të padisë sepse nuk janë të lidhur me vlefshmërinë e kontratës së kontestuar dhe/ose me bazat e anulimit të saj. Duke përmbledhur, pretendimet në ankesë sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK janë të pabazuara – *gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë nuk është as gabuar e as jo e plotë* sipas kriterëve të përcaktuara me Nenin 183 LPK.

Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale - Neni 184 LPK

26. Sipas Nenit 194 LCP, kjo Gjykatë e shkallës së dytë do të shqyrtoj Aktgjykimin e atakuar brenda arsyeve të cekura në ankesë, sikurse edhe *sipas detyrës zyrtare për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale* sipas Nenit 184 LPK.

Kundërshtimet me dispozitat e detyrueshme të Rregullores së UNMIK-ut

27. Me Rezolutën 1244 (1999) të 10 qershorit 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kombeve të Bashkuara, e autorizoj Sekretarin e Përgjithshëm, me ndihmën e organizatave relevante ndërkombëtare, që të themeloj praninë ndërkombëtare civile në Kosovë, për ta siguruar administrimin e

përkohshëm sipas Nenit 10 me përgjegjësitë e përcaktuara sipas Nenit 11. Sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme, gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Veçmas nga kjo dispozitë e përgjithshme, Neni 6 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1 në veçanti përcakton *inter alia* se UNMIK-u do të administrojë me *pronën e paluajtshme shtetërore* të regjistruar në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë ose të Republikës së Serbisë ose të njërit nga organet e saj, që gjenden në territorin e Kosovës. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/54 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/1 - Neni 6.1 ishte riformuluar duke siguruar që UNMIK-u do të administrojë me pronën e paluajtshme në territorin e Kosovës, ku ka bazë të arsyeshme dhe objektive për të konstatuar se është: (a) prone e, ose e regjistruar në emër të, Republikës Federative të Jugosllavisë ose të Republikës së Serbisë ose ndonjë organi të saj; ose (b) *pronë shoqërore*. Me që është e padëmshme për këtë administratë, Neni 6.2 e përcaktoi që vërtetimi i pronësisë ose të ndonjë të drejte tjetër sendore nga Gjykata kompetente në Kosovë ose nga një mekanizmi gjyqësor të themelohet sipas kësaj Rregulloreje. Për atë, Neni 6.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/1, si e ndryshuar e në fuqi që nga 27 tetor 2000 *vendosi tërë pronën e paluajtshme shoqërore në Kosovë nën administrim të UNMIK-ut* përmes organeve kompetente të tij.

28. Me 7 dhjetor 2000, me Nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/63 është themeluar Departamenti Administrativ i Industrisë dhe Tregtisë. Me Nenin 2.2 ky organ është autorizuar që të veprojë si administrator ose i besuari në lidhje me ndonjë ndërmarrje në territorin e Kosovës, të administruar nga UNMIK-u sipas Nenit 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/1, si të ndryshuar, *inter alia*, duke përfshirë këtu edhe asetet në pronësi shoqërore.

29. Edhe pas shpalljes së Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 me 15 maj 2001, bazuar në Nenin e saj 8.1 (q) Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nuk iu ishin dhënë kompetencat dhe përgjegjësitë, që ishin të rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, *për të administruar me pronën publike, shtetërore dhe shoqërore*. Më në fund, me 13 qershor 2002, hyri në fuqi rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Agjencia ishte themeluar si një trup i pavarur sipas Nenit 11.2 të Kornizës Kushtetuese (Neni 1.1.) me qëllimin kryesor *për të administruar me ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe asetet lidhur me ato* brenda kontekstit të Nenit 8.1 (q) të Kornizës Kushtetuese (Neni 2.1).

30. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 me 13 qershor 2002 (Neni 33), N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" e fitojë *ex leges* statusin e një ndërmarrjeje shoqërore nën administrim të AKM-së sipas Nenit 5.1. *Së pari*, duke marrë parasysh alternativat në definicionin e këtij termi sipas Nenit 3 ligjërisht është jorelevante nëse është krijuar si një ndërmarrje në pronësi shoqërore sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 77/1988 me amendamente në numrat e Gaz. Zyrtare Nr.40/1989, Nr.46/1990 dhe Nr. 61/1990), Ligjin mbi Punën e Bashkuar

(Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr.53/1976 me amendamente në numrat e Gaz. Zyrtare Nr. 57/1983, dhe Nr.85/1987) ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm sepse nuk ekziston transformim pasues që do të ndikonte në këtë status sipas Nenit 5.3 ose Nenit 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12. *Së dyti*, me 13 qershor 2002 N.Sh. "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" duke pasur kontrollin aktual të menaxhimit në GJILAN kishte punuar në territorin e Kosovës sipas Nenit 5.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12, *brenda kufijve të kompetencave të AKM-së* bazuar në Nenin 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12. Ky autoritet përfshin gjithashtu edhe pronën e patundshme - subjekt i kontratës Vr.nr.20151/02,të datës 6 shtator 2002 si një *aset në territorin e Kosovës të ndërmarrjes shoqërore*, i administruar dhe i menaxhuar që nga 10 qershori 1999 pavarësisht aseteve tjera jashtë Kosovës sipas nenit 5.2 (b) të rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12. Për këtë arsye AKM ka autoritetin të administrojë NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG", dhe ky lokal afarist konkret sipas neneve 5.1, 5.2 dhe 5.5 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12. *Së treti*, si rrjedhojë, AKM-së iu kishte dhënë autoriteti *administrativ* për këtë ndërmarrje, duke përfshirë fuqitë e numëruara ne paragrafin 6.1 (a) – (s) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12. Veç kësaj, për shkak të statusit të kësaj ndërmarrje si ndërmarrje shoqërore, AKM ka fuqi shtesë të merr veprime të duhura për të ruajtur dhe zhvilluar vlerën e zbatueshmërisë së aktiviteteve lidhur me të sipas nenit 6.2 (a) – (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12. Norma e fundit në mënyrë eksplicite autorizon AKM-në që të jetë në *dispozicion të të hollave dhe aseteve tjera në ndërmarrjet shoqërore*. Kjo ka qenë në *përgjithësi* e aplikueshme për të gjitha këto ndërmarrje të vendosura nën administrimin e AKM-së sipas paragrafit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, pa marrë parasysh nëse agjensioni ka pretenduar ose jo kontrollin e drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjet konkrete sipas nenit 6.1 (e) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12. Neni 6.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12 ishte formuluar për të gjitha llojet e aseteve, *duke përfshirë pronat e paluajtshme*. Fuqia për vendosjen e tyre ishte në mënyrë ekskluzive e dhënë AKM-së me nenin 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 pa mundësinë e ushtrimit të saj nga ndonjë organ menaxhues, kontrollues apo organ tjetër i ndërmarrjes-kombinim i biznesit të përditshëm i kryer nga ata dhe menaxhimi i përgjithshëm i AKM-së sipas nenit 7.1 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, në bazë të së cilës neni 7.2 ishte pa paragjykim vetëm për fuqinë administrative të AKM-së sipas nenit 6.1 dhe *per argumentum ad contrario* ishte në mospërputhshmëri me fuqitë administrative lidhur me privatizimin sipas nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 . Rrjedhimisht, AKM kishte autoritetin ekskluziv të vendosë për pronën e kontestuar të paluajtshme sipas nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 si një aset i ndërmarrjes shoqërore nën administrimin e saj sipas nenit 5.1. Kjo kërkesë imperative nuk ishte në përputhshmëri. Kontrata e ankimuar mbi transferin e pronësisë në ndërmarrjen shoqërore e administruar nga AKM që nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12 me 13 qershor 2002 ishte nënshkruar me 6 shtator 2002 *pa asnjë vendim të ndonjërit nga organet e AKM-së për lidhjen e saj*. Ky pëlqim nuk ishte dhënë paraprakisht si leje paraprake, në të njëjtën kohë nëpërmjet pjesëmarrjes si përfaqësues ligjor i NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" në

vërtetimin e Gjykatës Komonale të GJILANIT sipas nenit 29, paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, apo si miratim pasues. Mungesa e miratimit nga AKM si përfaqësues ligjor i NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" për dhënien e aseteve përjashton mungesën e marrëveshjes së përbashkët të palëve dhe për këtë arsye vullneti i tyre i përbashkët në elementet përbërëse të këtij transaksioni ligjor sipas nenit 26 LMD, i cili sipas nenit 55, paragrafi 6 LMD përjashton vlefshmërinë e kontratës dhe efektin e saj. Pa veprimin e AKM-së sipas nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, lidhja e kontratës së ankimuar lidhur me dhënien e një asemi të ndërmarrjes shoqërore është në kundërshtim me rregulloret e detyrueshme të përmendura më lart mbi administrimin e pronës shoqërore nga UNMIK-u nëpërmjet AKM-së dhe si e tillë është e pavlefshme sipas nenit 103, paragrafi 1 LMD. Ky përfundim i arritur nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me ligjin substancial pa dështim në aplikimin e tij sipas nenit 184 LPK.

Lënda e palejueshme

31. Gjykata e shkallës së dytë brenda shqyrtimit *ex officio* të ligjit substancial identifikon baza shtesë për pavlefshmërinë e kontratës së ankimuar lidhur me lëndën e saj sipas Nenit 46, paragrafi 1 LPK. *Së pari*, sipas nenit 160 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, asetet e një ndërmarrje përbëhen nga artikujt, të drejtat dhe paratë. Neni 163 i Ligjit mbi Ndërmarrjet i klasifikon ato si asete që mund të jenë lëndë e një transaksioni ligjor, dhe kur të jenë kështu të specifikuar me ligj në mënyrë restriktive, apo nuk do të jenë fare çështje e saj. Kështu që, asetet janë të kategorizuara në bazë të sistemit të tyre ligjor tregtar. Pasuria e paluajtshme e kontestuar i takon kategorisë së aseteve të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG", të transferueshme me restriksione të cilat në këtë lëndë nuk ishin zbatuar. *Së dyti*, Ligji mbi Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme, (Gazeta Zyrtare e RSS nr. 43/1981, 24/1985, 28/1987, 6/1989 dhe 40/1989) ("LQPP") hyri në fuqi me 10 gusht 1981 dhe duke qenë në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989 është i paaplikueshëm në këtë padi sipas nenit 1.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, i përmirësueshëm. LQPP rregullon, *inter alia*, tjetërsimin, shkëmbimin dhe çfarëdo vendosje tjetër të pronës së paluajtshme shoqërore – nenet 1 dhe 2 LQPP. Lidhur me ndërtesat shoqërore, pjesët e tyre dhe lokalet afariste, neni 13 paragrafi 1 LQPP lejon transferin e tyre nga një person juridik shoqëror në një person tjetër shoqëror përkundrejt dhe pa pagesë, kurse neni 13, paragrafi 2 LQPP kufizon tjetërsimin e tyre nga një person juridik shoqëror tek marrësi pa këtë status vetëm përkundrejt pagesës. Ky kufizim i fundit nuk ishte respektuar në këtë fjali – me kontratën e ankimuar NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" ishte e obliguar të transferojë një lokal afarist – aset shoqëror i kësaj ndërmarrje ISA KRASNIQIT pa marrur për të pagesë. Pasi që tjetërsimi i tillë është në mënyrë eksplicite i ndaluar me nenin 13, paragrafi 2 LQPP, kontrata është e pavlefshme dhe e zbrazët bazuar në nenin 3, paragrafi 3 LQPP. Kjo çështje e obligimit të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" nuk është e lejuar në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 2 LMD. Duke shkelur nenin 13, paragrafi 2 LQPP, ajo është e paligjshme, kurse në pajtim me nenin 47 LQPP kontrata është e pavlefshme. *Së treti*, kjo gjithashtu rezulton nga Ligji mbi Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta

Zyrtare e KSAK Nr. 45/1981 dhe 29/1986) (LQPP). Neni 7, paragrafi 2 LQPP përcakton se një *person juridik shoqëror mund vetëm të transferoj një lokal afarist shoqëror, apo një pjesë të veçantë të ndërtesës përkundër shpërblimit*. Neni 9, paragrafi 1 LQPP kërkon që transferi të kryhet nëpërmjet *tenderimit publik apo mbledhjes të ofertave me shkrim*, dhe vetëm nëse ato janë të pasuksesshme nëpërmjet *marrëveshjes direkte*. Neni 12, paragrafi 1 LQPP kërkon një kontratë me të cilën një person juridik shoqëror transferon një pronë të paluajtshme nga pronësia shoqërore për t'u anuluar nëse në kohën e lidhjes së saj, çmimi kontraktual nuk është në proporcion me çmimin e tregut. Asnjë nga këto kërkesa statutare imperative nuk janë plotësuar. *Së pari*, kontrata e kontestuar ishte lidhur në emër të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" për transferim të lokalit afarist shoqëror-pjesë të veçanta të ndërtesës pa pagesë të çfarëdo shpërblimi në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2 LQPP. Pasi që ky lloj i pronës së paluajtshme shoqërore nuk mund të tregtohet nën kushte të tilla, *tjetërsimi i saj falas pa shpërblim* kundërshton nenin 3, paragrafin 2 LQPP dhe është i pavlefshëm sipas nenit 3, paragrafi 3 LQPP. *Së dyti*, transferi ishte kryer nëpërmjet *marrëveshjes të drejtpërdrejt* e cila, sidoqoftë, nuk ishte paraprirë me *tenderim publik* të pasuksesshëm apo *mbledhje të ofertave me shkrim* në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 2 LQPP. Mosmbajtja e asnjërës nga këtë procedura konkurruese, edhe pse të detyrueshme për transferimin e pronave të paluajtshme shoqërore është shkak i tjetër për pavlefshmërinë e kësaj kontrate sipas nenit 9, paragrafi 2 LQPP. *Së treti*, kërkesa e domosdoshme e nenit 12, paragrafi 1 LQPP nuk ka qenë gjithashtu në përputhje. Asnjë çmim i kontratës nuk është miratuar për shitoren, për më shumë, një përpjesëtim me vlerën e saj të tregut në kohën kur kontrata ishte lidhur siç kërkohet ligjërisht me nenin 12, paragrafi 1 LQPP. Në pikën e saj I ishte përmendur vetëm shuma 14 790 Euro si kompenzim i duhur nga NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG për ISA KRASNIQIN, me asnjë vlerë të shitores të transferuar për përmbushjen e këtij obligimi, nuk është shënuar fare. Nuk është evidentuar nga i padituri në rastin e shkallës së parë, edhe pse ai kishte barrën sipas nenit 319, paragrafi 1 LPK për të dëshmuar *çmimin e tregut* të kësaj shitore të përcaktuar duke pasur parasysh çmimin e arritur në tregun e lirë, lokacionin dhe rrethanat në përputhje me nenin 12, paragrafi 2 LQPP. Për këtë arsye, nuk ka as bazë faktike dhe as bazë ligjore për të konsideruar shumën e 14 790 Eurove për kompenzim të dëmit si e *barabartë* me vlerën e tregut të shitores të transferuar në vend të pagesës të këtij obligimi në para. Pabarazia aetyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmohet nga Fatura e Pagesës së Taksës së Pronës së Paluajtshme nr.2662003, të lëshuar nga Komuna e GJILANIT me 30 prill 2003 në emër të ISA KRASNIQIT në të cilën çmimi i vlerës së shitores përcaktohet zyrtarisht në shumën e *52 800 Eurove*, e cila është *3.5 herë më e lartë sesa kompenzimi i 14 790 Eurove "të paguar" nga ajo*. Ky disproporcion në mes të borxhit, i përmbushur nga transferi i shitores dhe çmimi i saj i tregut qartazi kundërshton nenin 12, paragrafin 1 LQPP dhe duke qenë në disavantazh për NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" është bazë për anulimin e kontratës sipas nenit 12, paragrafi 1 LQPP. Ky i fundit, siç përcaktohet në mënyrë eksplicite me nenin 12, paragrafi 3 LQPP, *nuk mund të përjashtojë aplikimin e nenit 12, paragrafi 2 LQPP* sipas kërkesës së saj për transferimin e çfarëdo prone në

pronësi shoqërore përkundër çmimit, në minimum i barabartë me vlerën e saj të tregut. Pasi që neni 12, paragrafi 1 LQPP nuk mund të derogohet me kontratë sipas nenit 12, paragrafi 3 LQPP, shkelja e rregullës proporcionale shfuqizon këtë kontratë dhe kërkon anulimin e saj sipas nenit 12, paragrafi 1 LQPP. Për të përmbledhur, pasi që transferi i shitores së kontestuar pas marrëveshjes direkte ishte objekt i obligimit të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" të tjetërsojë këtë lokal afarist-pronësi shoqërore ISA KRASNIQIT pa pagesë përkundër saj, kontrata Vr.nr.2051/02, e datës 6 shtator 2002 është e pavlefshme në pajtim me nenin 49 LMD që ka qenë e nënshkruar me subjektin e paligjshëm. Mos-përputhja me restriksionet e detyrueshme të vendosura për këtë kategori të transaksioneve sipas nenit 163 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, domethënë tjetërsimin e papranueshëm të lokalit afarist të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" pa procedurë konkurruese, nën kushtet e pafavorshme, pa asnjë pagesë të çmimit në proporcion me çmimin e tregut, për plotësimin e një obligimi në një shumë 3 herë më të ulët, përfaqëson *de facto* privatizimin i cili është i paligjshëm dhe shfuqizon kontratën sipas nenit 103, paragrafi 1 LMD.

Autorizimi jo i rregullt

32. Në emër të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" kontrata Vr.nr.2051/02, ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale e GJILANIT me 6 shtator 2002 e nënshkruar nga sekretari ATULLA QERIMI. Sidoqoftë, autoriteti i tij që të përfaqësojë atë në lidhjen e këtij transaksioni nuk ishte i bazuar në ligj, një akt i përgjithshëm i këtij personi juridik, një akt i trupit kompetent apo autorizim në bazë të nenit 84, paragrafi 2 LMD. Në veçanti, autoriteti i tij si përfaqësues i autorizuar nuk mund të konsiderohet si i dhënë në mënyrë të rregullt me autorizimin nr.339/2002, të nënshkruar nga kryetari i Këshillit të Punëtorëve të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" SAMI KRASNIQI me 9 shtator 2002. Së pari, formulari i përshkruar me nenin 4, paragrafin 2 LQPP për vlefshmërinë e të gjitha kontratave mbi tjetërsimin e pronave të paluajtshme në pronësi shoqërore *ishte shkruar me vërtetimin e nënshkrimit të palëve nga gjykata*. Bazuar në nenin 90 LMD, I njëjti formularë aplikohet në autorizim për lidhjen e tyre. Pasi që në pajtim me nenin 89, paragrafi 1 LMD autorizimi jepet me transaksion ligjor, sanksioni për mungesën e këtij formulari ligjor të detyrueshëm sipas nenit 70, paragrafi 1 LMD ka mungesë të efektit ligjor. Kjo është saktësisht hipoteza. Autorizimi nr.339/02 i dhënë ATULLA QERIMIT, sekretar i NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" ishte nënshkruar me shkrim, por nuk ishte vërtetuar nga gjykata. Pa këtë formular të obligueshëm të përshkruar me nenin 90 LMD në lidhje me nenin 4, paragrafin 2 LQPP, ky autorizim është pa efekt juridik në pajtim me nenin 70, paragrafi 1 LMD dhe nuk iu është dhënë ATULLA QERIMIT autorizimi që të përfaqësojë NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" për nënshkrimin e kontratës. Së dyti, i njëjti autorizim ishte lëshuar me 9 shtator 2002, gjersa vërtetimi i kontratës, zyrtarisht i vërtetuar nga gjykata me efekt detyrues sipas nenit 329, paragrafi 1 LMD ishte me 6 shtator 2002. Ky zhvillim e bën të pamundshëm faktikisht dhe ligjërisht lidhjen e kësaj kontrate në bazë të këtij autorizimi – me 6 shtator 2002 ATULLA QERIMIT ende nuk iu kishte dhënë

autorizimi që të përfaqësojë NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" dhe nuk ka mundur të veprojë si përfaqësues i autorizuar në nënshkrimin e kontratës, duke konsideruar se autorizimi ishte lëshuar tri ditë më vonë, me 9 shtator 2002, pa pëlqim retroaktiv. *Së treti*, sipas nenit 91, paragrafi 1 LMD cilido përfaqësues i autorizuar mund të ndërmerë vetëm veprime juridike të cilat bien në fushëveprimin e autorizimit të tij. Një transaksion që shkon përtej punës së rregullt kërkon autorizim të veçantë sipas nenit 91, paragrafi 3 LMD. Në këtë rast, me autorizimin nr.339/02 ATULLA QERIMI ishte i autorizuar të përfaqësojë NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" në nënshkrimin e kontratës mbi transferin e shitores në GJILAN në emër të ISA KRASNIQIT. Sidoqoftë kjo pronë e paluajtshme nuk ishte individualizuar me lokacionin e saj të saktë - rrugën, ndërtesën dhe numrin, sipërfaqen apo ndonjë të dhënë tjetër as drejtëpërdrejtë me autorizim e as në mënyrë indirekte me referencë të dokumentit që e përmbante këtë informacion. Kështu që shitorja, në mënyrë të përgjithshme e përshkruar në autorizim, nuk mund të identifikohet me atë të specifikuar në detaje në kontratë. Pa këtë korrespondencë, transferi i saj nuk mund të konsiderohet se bie në fushëveprimin e autorizimit të ATULLA QERIMIT për NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" siç kërkohet me nenin 91, paragrafi 1 LMD, e cila përveç kësaj l mungon individualiteti l kërkuar me nenin 91, paragrafi 2 LMD. Për këtë arsye ATULLA QERIMIT nuk iu kishte dhënë autorizimi që të veprojë si përfaqësues i autorizuar për NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" në lidhjen e kontratës për transferim të shitores, e cila gjindet ne GJILAN, në ndërtesën me lokale banuese dhe komerciale P+6+PK, numri teknik i projektit kryesor 494-lokali afarist "D" P+6+PK, ish rruga "RADE POPOVIC", tani rruga "BRIGADA e UÇK-së" me sipërfaqe prej 38.65 m², e regjistruar në Listën Poseduese nr.4650, KK GJILAN, pasi që individualizmi i pronës së patundshme *nuk ishte përfshirë* në autorizimin e tij sipas nenit 89, paragrafi 1 LMD. *Së katërti*, e njëjta ishte nënshkruar nga SAMI KRASNIQI si Kryetar i Këshillit të Punëtorëve të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG", i cili nuk ka pasur të drejtë të jep atë bazuar në ligj, një akt i përgjithshëm i këtij personi juridik , një veprim i trupit kompetent apo përfaqësuesit të tij ligjor në pajtim me nenin 84, paragrafi 1 LMD. Sipas nenit 47, paragrafi 1 i Ligjit mbi Ndërmarrjet , *trupi menaxhues i ndërmarrjes shoqërore* në atë kohë ishte Këshilli i Punëtorëve , i përbërë nga delegatët e zgjedhur nga punëtorët sipas nenit 47, paragrafët 2 – 4, duke marrur vendime me votimin e shumicës nga të gjithë anëtarët sipas nenit 50 me kompetenca sipas nenit 49. Për këtë arsye vetëm Këshilli i Punëtorëve si *trup kolektiv* ishte autorizuar me fuqi, gjersa Kryetari i saj nuk e ka pasur statusin e *trupit të saj individual* dhe nuk iu është dhënë asnjë kompetencë, duke përfshirë edhe atë që të autorizojë ATULLA QERIMIN që të nënshkruajë kontratën e kundërshtuar. Nuk ka pasur asnjë *urdhëresë* të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" sipas nenit 51 të Ligjit mbi Ndërmarrjet apo *ndonjë veprim tjetër të përgjithshëm të kësaj ndërmarrje shoqërore* që e ofron këtë autoritet për Kryetarin e Këshillit të Punëtorëve. Nuk ka pasur *asnjë akt të trupit kompetent* lidhur me këtë, respektivisht vendim të AKM-së sipas nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12. Kryetari i Këshillit të Punëtorëve nuk ka mundur të nënshkruaj autorizimin nr.339/02, të datës 9 shtator 2002 si përfaqësues ligjor r kësaj ndërmarrje pasi që vetëm *Drejtori* i NSH

“INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” mund të veproj në këtë mënyrë sipas nenit 57, paragrafi 1 i Ligjit mbi Ndërmarrjet. Për të gjitha këto mangësi në formën e saj, datën, përmbajtjen dhe autorin, ky autorizim i ATULLA QERIMI ishte pa veprim juridik. Bazuar në autorizimin e papranueshëm, ky person nuk ka *pasur autoritet të nënshkruaj kontratën*. Si sekretar i NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” ai nuk ka qenë i autorizuar të përfaqësojë atë në çfarëdo baze alternative në nenin 84, paragrafi 1 LMD- bazuar në ligj, një akt i përgjithshëm Iikësaj ndërmarrje apo vendim të AKM-së si trup kompetent sipas nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/12. Kështu që, kontrata ishte lidhur në emër të NSH“INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” nga ATULLA QERIMI pa autorizimin e nevojshëm për ta përfaqësuar atë. E nënshkruar nga një person i paautorizuar pa aprovim pasues të drejtorit, kontrata është ligjërisht joefektive në pajtim me nenin 88, paragrafi 3 LMD.

Datio in solutum

33. Pas ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënies së tij të punës me NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG”, ISA KRASNIQI ka pasur të drejtën e kompensimit për të ardhurat e tij personale deri në kthimin e tij në punë bazuar në nenin 232, paragrafi 1 LPP 1978. Sipas nenit 307, paragrafi 1 LMD obligim përgjegjës i kësaj ndërmarrje-punëtorit duhej të plotësohej duke kryer atë çka e përbënte përmbajtjen e saj -shumën e duhur të parave për këtë dëmshpërblim . Bazuar në përjashtimin sipas nenit 308, paragrafi 1 LMD, ndërprerja e këtij obligimi ishte gjithashtu e mundshme nëse kreditori, pas marrëveshjes me debitorin të pranoj diçka tjetër në vend të asaj çka ka qenë e obligueshme për të. Sidoqoftë, pasi që në lëndë ishte miratuar pagesa e borxhit monetar e ISA KRASNIQIT sipas nenit 232, paragrafi 1 LPP 1978 të zëvendësohet me *transfer të pronës së patundshme të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG”* dispozita e detyrueshme e nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 e cila është e aplikueshme në mënyrë të përgjithshme për të gjitha format e disponimit të të gjitha llojeve të asetëve të ndërmarrjeve shoqërore duhet të jenë në përputhje. Nuk mund të konsiderohet e deroguar me nenin 308, paragrafi 1 LMD pasi që neni 32 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 zëvendëson çfarëdo dispozite të ligjit të aplikueshëm e cila është në kundërshtim me të. Si zëvendësim i përmbushjes (*datio in solutum*) ishte miratuar me transferin e pronësisë – asetin NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” në vend të pagesës së borxhit monetar për ISA KRASNIQIN, në pajtim me të dyja- nenin 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 dhe nenin 308, paragrafi 1 LMD kërkohej në mënyrë kumulative. Kjo është pse mungesa e vendimit të AKM-së për rregullime të tilla, të kundërshtueshme me nenin 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 ka anuluar transferin e kontestueshëm të pasurisë së patundshme të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” dhe si rrjedhojë e kësaj ka anuluar zëvendësimin ndihmës të përmbushjes (*datio in solutum*) sipas nenit 308, paragrafi 1 LMD bazuar në të. Motivet e palëve për hyrjen në këto marrëveshje, të numëruara në ankesë - mungesa e pretenduar e mjeteve financiare të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” të paguajë borxhin, periudha e gjatë kohore e procedurave civile për kontestin e punës me ISA KRASNIQIN dhe nevoja që të gjendet një marrëveshje për procedurën

ekzekutive në pritje sipas Kapitullit XVIII të LPP 1978 sipas nenit 53, paragrafi 1 LMD nuk e ndikojnë vlefshmërinë e kësaj kontrate dhe duke qenë jorelevante për të, nuk ka mundur të neutralizojë anulimin e tij. Pasi që autonomia e zgjedhjes së palëve për të rregulluar obligimet e tyre nuk është absolute, por e kufizuar me nenin 10 LMD në kufizimet e legjislacionit të detyrueshëm, kundërshtimi me rregulloret e saj e bën kontratën e kontestuar të pavlefshme sipas nenit 103, paragrafi 1 LMD, pa marrë parasysh përshtatshmërinë e saj. Kjo i referohet gjithashtu argumentit në ankesë për mungesë të dëmit nga konkludimi i saj- moszhvillimi i tyre nuk rezulton në zhdukje pasuese të shkaqeve të anulueshmërisë të kësaj kontrate dhe për këtë arsye nuk e fuqizon atë sipas nenit 107, paragrafi 1 LMD. Pasi që nuk ka asnjë efekt juridik, obligimi monetar sipas nenit 232, paragrafi 1 LPP 1978 të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” për ISA KRASNIQIN nuk është ndërprerë sipas nenit 308, paragrafi 1 LMD dhe *secila palë duhet të dëmshpërblejë tjetrën për çdo gjë që është marrur në bazën e saj*. Sipas nenit 104, paragrafi 1 LMD këto janë *pasojat e pavlefshmërisë së kontratës, e jo arsyet që të përjashtojë pavlefshmërinë e saj*. Edhe pse është lidhur me 9 shtator 2002 pas procedurës ekzekutive në E.nr.26/97 të Gjykatës Komunale të GJILANIT ishte iniciuar me 4 mars 1997 dhe rifilloi në E.nr.51/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT me 1 maj 2002, kontrata ishte arritur si marrëveshje jo e ligjshme jashtë kësaj procedure ekzekutive. Shitorja e kontestuar nuk i ishte shitur ISA KRASNIQIT pas shitjes publike apo marrëveshjes së drejtpërdrejtë sipas neneve 156 – 167 LPP 1978, e as borxhi i NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” nuk ishte përmbushur me shumën nga shitja sipas neneve 170 – 175 LPP 1978. Pasi që kontrata ishte lidhur *jashtë procedurës ekzekutive në pritje*, nuk mund të konsiderohet e vlefshme në pajtim me nenin 184 LPK, gjersa të drejtat e NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” mbi pasurinë e patundshme – çështje e saj nuk ishte penguar me dispozitën e njëjtë.

34. Të pabazuara janë të gjitha argumentet tjera të përmendura në ankesë sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK. *Së pari*, vërtetimi i kontratës së kontestuar si Vr.2051/02 nga Gjykata Komunale e Gjilanit me 6 shtator 2002 është një element i *formularit* të përshkruar sipas nenit 67 *in fine* LMD në lidhje me nenin 4, paragrafi 2 LQPP. Përputhshmëria me këtë kusht për vlefshmërinë e saj përjashton vetëm sanksionin sipas nenit 70, paragrafi 1 LMD për mungesë të këtij formulari. Ai nuk përjashton mos-përputhshmërinë me kushtet tjera të parashikuara për vlefshmërinë dhe pasojat e saj. Vërtetimi nga gjykata nuk e vërteton përputhshmërinë me të gjitha ato si garancion absolut për ligjshmërinë e kontratës dhe nuk e pengon të drejtën për të kërkuar si rrjedhojë pavlefshmërinë e saj sipas nenit 110 LMD mbi këto baza. *Së dyti*, kjo nuk është dëshmuar se Këshilli i Punëtorëve të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” si trupi më i lartë menaxhues në bazë të nenit 49 të Ligjit mbi Ndërmarrjet kurrë nuk ka marrur vendim për transfer të pronës së paluajtshme të kontestuar me kuorumin dhe shumicën e nevojitur me nenin 50. Mungesa e saj nuk mund të konsiderohet si e neutralizuar me vendimin nr.118/2002 i Komisionit për çështje të pronësisë të pronës së paluajtshme, me datë 6 gusht 2002 pasi që në lëndë nuk është dëshmuar asnjë urdhëresë e NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” të atyre të parashikuara në nenin 51 të Ligjit mbi Ndërmarrjet i cila rregullon formimin

dhe funksionin e saj. Për më shumë, ky vendim ishte marrur nga Komisioni me 8 gusht me pjesëmarrje të ALAUDIN SHERIFIT, megjithëse ai ishte zgjedhur si anëtarë të saj nga Këshilli i Punëtorëve me 8 gusht 2002. Megjithatë, autoriteti i AK-së i vendosur pas 13 qershorit 2002 për dhënie të të gjitha aseteve të të gjitha ndërmarrjeve shoqërore sipas nenit 6.2 (c) të rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 duke qenë deroguese në mënyrë *eksklusive* derogon kompetencat e të gjithë organeve të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" lidhur me këtë çështje. Asnjë nga ato nuk mund të zëvendësojë AKM-në në autorizimin e transferit të lokaleve afariste të kontestuara të kësaj ndërmarrje shoqërore. Mungesa e vendimit të AKM-së për tjetërsimin e saj shkel dispozitën e detyrueshme të nenit 6.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 dhe sipas nenit 103, paragrafi 1 LMD çon kah pavlefshmëria e plotë e kontratës së kontestuar si bazë e cila plotëson anulimin e saj, përveç të gjitha shkeljeve tjera të përmendura më lart në konkluzionin e saj-arsyet për të qenë e pavlefshme dhe e zbrazët. *Së treti*, referimi në nenin 107 LMD i përfshirë në ankesë është i pabazuar. Shkaku kryesor për pavlefshmërinë e kontratës – mungesa e miratimit të AKM-së si shkelje sipas nenit 103, paragrafi 1 LMD dhe neni 6.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 si rrjedhojë nuk është zhdukur. Kjo kërkesë nuk ishte anuluar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2005/18 që e ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12, por e ruajtur dhe e rinumëruar si paragrafi 6.2 (d), i cili rrjedhimisht nuk ishte ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/16 dhe/apo Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/27. Autoritet identik iu kishte dhënë Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) me nenin 6, paragrafin 2, pika d) e Ligjit nr. 03/L-067 dhe me vonë me nenin 6, paragrafi 2, nën-paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-034. Derisa rregulloret e obligueshme të shkelura nga kontrata e kontestuar në 2002 mbeti pjesë e e sistemit ligjor për vendosjen e aseteve të NSH nga AKM dhe pastaj AKP, ndalesa për ushtrimin e kësaj kompetence nga organet e NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" rrjedhimisht nuk ishte zhdukur dhe kontrata nuk është bërë e vlefshme bazuar në nenin 107, paragrafi 1 LMD. Pasi që ky ndalim nuk ishte i rëndësishëm së vogël , pavlefshmëria e saj nuk ishte penguar për shkak të performansës bazuar në nenin 107, paragrafi 2 LMD. *Së katërti*, borxhi i NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" të kompenzojë ISA KRASNIQIN për të ardhurat e mosmarrura personale sipas nenit 232, paragrafi 1 LPP 1978 *ndodhi* sipas dispozitës së njëjtë me 23 dhjetor 1996, kur aktgjykimi C.nr.236/92 i Gjykatës Komunale të GJILANIT i datës 11 qershor 1996 hyri në fuqi. Pasi që ISA KRASNIQI nuk ishte kthyer në punën e tij në NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG", ky kompenzim për të ardhurat e mosmarrura personale –është rritur vazhdimisht në periudhën e vonesës sipas nenit 232, paragrafi 5 LPP 1978. Marrëveshja që të *ndërpritet* ky obligim duke zëvendësuar pagesën e borxhit monetar të NSH "INDUSTRIA E BATERIVE-IBG" me *transferimin* e shitores – asetit i saj në pronësi të ISA KRASNIQIT sipas nenit 308, paragrafi 1 LMD, si dhe formalizimi i saj nëpërmjet kontratës së kontestuar ndodhi në datën e vërtetimit të saj nga Gjykata Komunale e GJILANIT – 6 shtator 2002. Në atë kohë, dispozitat e detyrueshme të përmendura më lart në administrimin e pronave të paluajtshme shoqërore, duke përfshirë asetet e NSH, me UNMIK-un nëpërmjet AKM-së ishin në fuqi. Neni 6.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/12 në veçanti hyri në fuqi me

aktgjykimi C.nr.236/92 i Gjykatës Komonale të GJILANIT i datës 11 qershor 1996 hyri në fuqi. Pasi që ISA KRASNIQI nuk ishte kthyer në punën e tij në NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG”, ky kompenzim për të ardhurat e mosmarrura personale është rritur vazhdimisht në periudhën e vonesës sipas nenit 232, paragrafi 5 LPP 1978. Marrëveshja që të *ndërpritet* ky obligim duke zëvendësuar pagesën e borxhit monetar të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG” me *transferimin* e shitores asetit i saj në pronësi të ISA KRASNIQIT sipas nenit 308, paragrafi LMD, si dhe formalizimi i saj nëpërmjet kontratës së kontestuar ndodhi në datën e vërtetimit të saj nga Gjykata Komonale e GJILANIT – 6 shtator 2002. Në atë kohë, dispozitat e detyrueshme të përmendura më lart në administrimin e pronave të paluajtshme shoqërore, duke përfshirë asetet e NSH, me UNMIK-un nëpërmjet AKM-së ishin në fuqi. Neni 6.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/12 në veçanti hyri në fuqi me 13 qershor 2002 si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 për vendosje të aseteve të NSH pas kësaj date. Fjalja në ankesë për mos aplikimin e tyre është e bazuar gabimisht në *momentin e ndodhjes së borxhit*, kurse relevante për vlefshmërinë e kontratës së kontestuar ishte *momenti i lidhjes të saj* me 6 shtator 2002. *Së pesti*, deklarata e EROLL IMAMIT i cili ishte person zyrtar në Gjykatën komonale të GJILANIT e vërtetoi atë për mos-nevojë të pëlqimit të AKM-së dhe ligjshmërisë së procedurës, të dëgjuar në shkallën e parë, përfaqëson *mendimin ligjor* i cili ishte i papranueshëm si dëshmi e dëshmitarit, nuk ka vlerë dëshmuese dhe nuk është detyruese për gjykatën. *Së gjashti*, pasojat e *mos-përmbylljes eventuale të kontratës* – mos-përmbushjen e obligimit të NSH “INDUSTRIA E BATERIVE-IBG”, tani NSH “FABRIKA E BATERIVE”, sipas nenit 232, paragrafi 1 LPP 1978 dhe mos-kompenzimin e ISA KRASNIQIT – nuk i derogojnë *kërkesat e vlefshmërisë për përmbylljen e kontratës së njëjtë* dhe nuk e përjashtojnë pavlefshmërinë e saj si sanksion për mos-përputhje me ato.

35. Ekzaminimi ankimor nuk ka zbuluar asnjë aplikim të gabueshëm të ligjit substancial sipas nenit 181, paragrafi 1, pika c) LPK – me anulimin e kontratës së kontestuar si të pavlefshme dhe të zbrazët, Gjykata Komonale e GJILANIT as nuk ka dështuar së implementuari dispozitat e duhura të ligjit të aplikueshëm, e as nuk i ka aplikuar ato në mënyrë të rregullt sipas nenit 184 LPK.

VI. Përfundim

36. Duke u bazuar në faktet e përmendura më lart, gjykata e shkallës së dytë refuzon ankesën si të pabazuar dhe konfirmon aktgjykimin C.nr.127/2005 të Gjykatës Komonale të GJILANIT të datës 4 dhjetor 2009 në pajtim me nenin 195, paragrafin 1, pika d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së. Ky aktgjykim është nxjerrur ligjërisht pa baza për ankimim sipas nenit 181, paragrafi 1, pikat a) – c) LPK të thirrur në ankesë apo të tjera të identifikuara *ex officio* nga gjykata e shkallës së dytë.

Në lidhje me arsyetimin e përmendur më lart është vendosur si në dispozitiv.


MJETI JURIDIK: Asnjë mjet juridik nuk lejohet kundër këtij aktgjykimi.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

AC.nr.49/2011 me 23.12.2011

KRYETARE E TRUPIT GJYKUES

ROSITZA BUZOVA



QARKU I GJILANIT
GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT
KRYETARE E TRUPIT GJYKUES

[Handwritten signature]
Rositza Buzova

Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:
Xhangyle Ilijazi, perkthyes ne EULEX**

[Handwritten signature]

NJOFTIM MBI KËSHILLIM DHE VOTIM

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si kryetare e kolegjit, gjyqtari vendor MUHAMET REXHA dhe gjyqtari vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtarë të kolegjit, me 23 dhjetor 2011 diskutuan dhe votuan unanimitisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Ky njoftim i bashkëngjitet Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT AC. nr.49/2011, të datës 23 dhjetor 2011 në pajtim me nenin 140 , paragrafi 1, fjalia e dytë e LPK-së.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

AC.nr.49/2011 me 23.12.2011

ROSITZA BUZOVA

Kryetare e trupit gjykues

MUHAMET REXHA

Anëtar i trupit gjykues

ABDULLAH AHMETI

Anëtar i trupit gjykues

ANDRES MORENO

Zyrtar ligjor i EULEX-it

DAUT LATIFAJ

Përkthyes (Anglisht/shqip)

Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe e nënshkruar nga gjyqtarët vendor pas përkthimit të bërë nga përkthyesja e cekur më lart.

Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:

Xhangyle Ilijazi, perkthyes ne EULEX

